



Republika e Kosovës
Qeveria e Kosovës

OMBUDSPERSON
INSTITUTION

21 -02- 2008

9/12/2008

RECEIVING

19 02 08

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE

DEPARTAMENTI LIGJOR

Për : z. Hilmi Jashari, ushtrues i detyrës së Ombudspersonit në Kosovë,

Cc : z. Hashim Thaqi, Kryeministër i Qeverisë së Kosovës, z. Gjergj Dedaj, zv.Ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, znj. Justina Pula, Ministre e Ministrisë së Minierave dhe, Energjetikës, z. Ahmet Shala, Ministër i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, z. Fatmir Limaj, Ministër i Ministrisë së Transportit dhe Post Telekomunikacionit, z. Mahir Jakgjillar, Ministër i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, z. Remzi Shahini, U.D i Drejtorit Menaxhues në KEK.

Përmes : z. Eshref Shabani, Sekretar i Përhershëm i MPMS-së

Nga : Fadil Racaj, Drejtor i Departamentit Ligjor të MPMS-së

Lënda : Zbatimi i dispozitave ligjore të nenit 13 të Ligjit nr. 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuar

I nderuari z. Jashari

Lidhur me kërkesën e juaj të datës 11.02.2008, drejtuar z. Hashim Thaqi, Kryeministër i Kosovës, e cila ka të bëjë me nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e nenit 13 të Ligjit nr. 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë, ju njoftojmë si vijon:

Me dispozitat e Ligjit nr. 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë, rregullohet skema e pensioneve të aftësisë së kufizuar për qytetarët e moshës 18-64 vjet të cilët janë përherë dhe plotësisht me aftësi të kufizuara.

Objektivi themelor i kësaj skeme të pensioneve të aftësisë së kufizuar është që kategorisë së personave me aftësi të kufizuar t'u ofroj ndihmë financiare përmes shfrytëzimit të pensioneve të aftësisë së kufizuar dhe realizimin e beneficioneve të ndryshme të përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr. 2003/23.

Sipas dispozitave të nenit 13 të Ligjit në fjalë, shfrytëzuesit e personave me aftësisë të kufizuar kanë të drejtë në këto beneficione:

- Të drejtën në udhëtim në trafikun urban falas, ndërsa në trafikun ndërrurban me lirim prej 50% të vlerës së biletës, si dhe rezervimin i vendeve të caktuara në mjetet e udhëtimit të trafikut urban dhe ndërrurban. (kushtet kriteret dhe procedurat për realizimin e këtij beneficioni nga personat me aftësi të kufizuar duhet të rregullohet dhe përcaktohen me akt nënligjor të nxjerr nga Ministria e Transporti dhe Post-Telekomit.).

- b. Të drejtën në bileta hyrëse për manifestimet artistike, kulturore dhe sportive me lirim prej 50% nga çmimi i biletës (kushtet kriteret dhe procedurat për realizimin e këtij beneficioni nga personat me aftësi të kufizuar duhet të rregullohen dhe përcaktohen me akt nënligjor të nxjerr nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit) .
- c. Të drejtën për të siguruar qasje të përshtatshme dhe lëvizje papengesa në të gjitha objektet publike (kushtet kriteret dhe procedurat për realizimin e këtij beneficioni nga personat me aftësi të kufizuar duhet të rregullohen dhe përcaktohen me akt nënligjor të nxjerr nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor) .
- d. Të drejtën në lehtësime nga taksat doganore për mjete, të cilat ndihmojnë integrimin e personave me aftësi të kufizuar në jetën shoqërore, si mjetet lëvizëse dhe pajisjet ortopedike të dëgjimit apo të pamurit, duke përfshirë edhe autovetura të përshtatshme për përdorimin e tyre. (kushtet , kriteret dhe procedurat për realizimin e këtij beneficioni , nga personat me aftësi përherë dhe plotësisht të kufizuar duhet të rregullohen dhe përcaktohen me akt nënligjor të nxjerr nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në bashkëpunim me Shërbimin Doganor të Kosovës).
- e. Të drejtën në tarifatat reduktuara dhe të lirimit të konsumimit të energjisë elektrike (kushtet , kriteret dhe procedurat për realizimin e këtij beneficioni , nga personat me aftësi përherë dhe plotësisht të kufizuara duhet të rregullohen dhe përcaktohen me akt nënligjor të nxjerr nga Ministria e Energjisë dhe Minierave).

Nga kjo që potencuam më lartë, shihet se realizimi i beneficioneve të përcaktuara në nenin 13 të Ligjit nr.2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuara , ekskluzivisht varet nga nxjerrja e akteve nënligjore të Ministrive përkatëse të përmendura më lartë.

Lidhur me këtë detyrim ligjor të ministrive të përmendura më lartë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale , në cilësinë e sponsoruesit të Ligjit , ka reaguar disa herë ,duke ju rekomanduar Ministrive kompetente, nxjerrjen e akteve nënligjore.

Herën e fundit, kjo Ministri ka reaguar me 14.02.2008 , duke kërkuar edhe njëherë nxjerrjen e akteve nënligjore nga Ministrinë përkatëse të cilat janë përgjegjëse për nxjerrjen dhe miratimin e dispozitave ligjore të cilat do të rregullojnë dhe përcaktojnë kushtet dhe kriteret për realizimin e beneficioneve nga personat me aftësi të kufizuara.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ka mirëpritur ripërsëritjen e kërkesës me 11.02.2008 nga Avokati i Popullit të Kosovës, drejtuar disa prej ministrive të cilat janë përgjegjëse për nxjerrjen e këtyre akteve nënligjore, me ç'rast për këtë rekomandim u është shumë mirënjohës.

Shpresojmë se rekomandimet e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale si dhe ripërsëritja e Kërkesës nga Avokati i Popullit për nxjerrjen e akteve nënligjore , për përcaktimin kushteve , kriterëve dhe procedurave për realizimin e beneficioneve në nenin 13 të Ligjit të përmendur, nga Ministrinë përkatëse të Qeverisë së Kosovës , do të ndikojnë, që në të ardhmen e afërt , personat përherë dhe plotësisht me aftësi të kufizuara, mund ti realizojnë beneficionet e përcaktuara në nenin 13 të ligjit 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Shtojcë: Kërkesa e fundit e MPMS-së , drejtuar Ministrive përkatëse , për nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e drejt dhe të plotë të Ligjit nr.2003/23.

Me respekt

Datë : 15 shkurt, 2008